



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0680

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) 2A Group SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, me 09.10.2025, mori:

Vendim

1. Hedhet posht, si e palejuar ankesa e OE 2A Group SH.P.K., me nr. 2025/0680, e datës 21.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.
2. I lejohet, Autoritetit Kontraktues që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull Menaxhimi i mbeturinave, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1,(AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.11.2024, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar: procedurën e hapur; lloji i kontratës: shërbim; vlera e parashikuar e kontratës: 16,500,000.00 €.

Me 11.07.2025 OE 2A Group SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 18.07.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.07.2025, OE 2A Group SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0680/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit Menaxhimi i mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Administrata e Organit Shqyrtues i Prokurimit pa i vlersuar dispozitat ligjore siq parashihi në nenin 108/A, dhe 109 -të LPP-së ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Administratat pran Organit Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues 2A Group SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

“2A Group Sh.p.k.” ka dorëzuar një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, menjëherë pas momentit kur u bë e qartë se procedura e prokurimit kishte rifilluar pa asnjë njoftim formal dhe të vlefshëm ndaj kompanisë sonë.

Konkretisht, më datë 09.07.2025, kompania jonë ka pranuar një njoftim automatik nga sistemi i e-prokurimit, që informonte për publikimin e një dokumenti të ri në dosjen e tenderit – “Procesverbali i Hapjes së Ofertave”. Ky ishte momenti i parë kur mësuam se procedura ishte rifilluar dhe se ne kishim humbur mundësinë për të dorëzuar ofertën.

Më datë 11.07.2025, ne parashtruam një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në të cilën parashtuam:

- mungesën e njoftimit formal për rifillimin e procedurës;
- pamundësinë për të dorëzuar ofertë;
- dhe cenimin e barazisë në trajtim me OE-të e tjerë që kanë dorëzuar ofertat e tyre.

Autoriteti Kontraktues në vendimin me nr. prot. 06 nr. 61238, të datës 18.07.2025, ka refuzuar shqyrtimin e kërkesës, duke pretenduar se “2A Group SH.P.K.” nuk është palë e interesuar, meqë nuk ka dorëzuar ofertë dhe rrjedhimisht nuk ka status për të kërkuar rishqyrtim.

Ky veprim përbën një shtrembërim të qëllimshëm të së vërtetës faktike dhe një keqinterpretim të rëndë të normës juridike. Ai është përdorur si mjet për të shmangur shqyrtimin real të një shkeljeje evidente dhe për të justifikuar me formë një padrejtësi të thellë. Ky pozicion nuk përputhet as me ligjin, as me praktikën e ndershme administrative, dhe synon të mbulojë pasojat e një njoftimi të munguar, duke e përjashtuar padrejtësisht operatorin ekonomik nga gara. Kjo

sjellje jo vetëm që deformon procesin e prokurimit, por e çon atë drejt një rezultati të paligjshëm dhe të papranueshëm në një sistem publik të drejtë dhe transparent.

Faktikisht, mungesa e dorëzimit të ofertës ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i mosnjoftimit formal dhe të vlefshëm nga AK.

AK nuk ka përdorur format e kërkuara nga ligji për të informuar OE-në tonë mbi rifillimin e procedurës (nuk është përdorur as “Publikimi i B58”, as publikimi si dokument shtesë, e as dërguar ndonjë njoftim automatik për vendimin e datës 07.07.2025). Prandaj, nuk mund të na kërkohej dorëzimi i ofertës si parakusht për legjitimitet, kur vetë AK-ja ka penguar mundësinë për pjesëmarrje.

Në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së, “palë e interesuar” nuk do të thotë vetëm OE që ka dorëzuar ofertë, por edhe ai që ka shprehur interes dhe ka qenë i lidhur me procedurën përkatëse. “2A Group SH.P.K.” ka qenë operator i regjistruar dhe i interesuar në këtë procedurë, dhe është lidhur me të në sistem. Mospjesëmarrja e mëvonshme nuk është zgjedhje, por pasojë e shkeljes procedurale të AK-së.

Në dritën e nenit 108/A të LPP-së, AK ka pasur detyrimin që kërkesën për rishqyrtim ta shqyrtojë në thelb dhe jo ta refuzojë për arsye formale, kur shkelja është evidente dhe e lidhur me vetë njoftimin për procedurën.

Refuzimi i shqyrtimit ka prodhuar efekt zinxhir të dëmshëm:

- ka bllokuar korrigjimin e menjëhershëm të shkeljes;
- ka lejuar që procedura të vazhdojë drejt përfundimit pa pjesëmarrjen tonë;
- dhe ka forcuar pasojat ekonomike dhe juridike mbi OE-në tonë.

Në këto kushte, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim duhet të konsiderohet si shkelje e rëndë e të drejtës për mjete juridike efektive dhe si një pengesë e paligjshme për zbatimin e parimit të pjesëmarrjes së barabartë në prokurim publik. Edhe ky veprim i Autoritetit Kontraktues duhet të merret parasysh në vlerësimin e OSHP-së për të konstatuar shkeljen e natyrës jo të korrigjueshme dhe për të vendosur anulimin e procedurës së prokurimit sipas nenit 62 të LPP-së.

Përmbledhje e shkeljeve të kryera nga Autoriteti Kontraktues

I. Shkelje të lidhura me rrjedhën e përgjithshme të procedurës së prokurimit

Shkelje e nenit 7 të LPP-së, për cenimin e barazisë dhe transparencës, duke mos njoftuar OE-në për rifillimin e procedurës dhe duke lejuar dorëzimin e ofertave nga OE të tjerë të informuar në mënyrë të pabarabartë.

Shkelje e nenit 55 të LPP-së, për mungesën e një komunikimi të vlefshëm dhe formal, duke mos përdorur kanalet e duhura.

Shkelje e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e cila përcakton mënyrat e komunikimit dhe funksionin e detyrueshëm të shpërndarjes së dokumenteve, në kuptim të nenit 87.2.4 të LPP-së, për mosrespektimin e manualeve dhe udhëzimeve të detyrueshme të KRPP-së

mbi mënyrën e njoftimeve zyrtare.

Shkelje e nenit 62 të LPP-së, duke vazhduar procedurën edhe pas një shkeljeje që është e natyrës jo të korigjueshme dhe që ka çuar në përjashtimin real të një OE-je të interesuar.

II. Shkelje të lidhura me trajtimin e kërkesës për rishqyrtim

Refuzimi i shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, edhe pse kërkesa ishte dorëzuar në afat dhe nga një OE i interesuar realisht. Mospërmbushja e detyrimit për trajtim real dhe substancial të pretendimeve, duke e refuzuar ankesën vetëm mbi bazë të një justifikimi formal dhe proceduralisht të gabuar.

Keqinterpretimi dhe aplikimi i gabuar i nenit 4.1.26 të LPP-së, duke përjashtuar nga legjitimiteti një OE që nuk kishte dorëzuar ofertë për arsye të shkaktuara nga vetë mosveprimi i AK-së.

Konkluzion i përmbledhur

Të gjitha këto shkelje, në mënyrë të ndërlidhur dhe progresive, kanë prodhuar pasoja të rënda dhe të pakorigjueshme për “2A Group SH.P.K.”, duke e përjashtuar nga gara në mënyrë të padrejtë dhe duke cenuar vetë legjitimitetin e aktivitetit të prokurimit. Kjo përbën bazë të mjaftueshme për pezullimin dhe anulimin e procedurës.

Karakteri thelbësor i shkeljes dhe objekti i ankesës

Thelbi i kësaj ankese qëndron në një shkelje të rëndë, thelbësore dhe të pakorigjueshme të së drejtës sonë për pjesëmarrje efektive, të barabartë dhe të informuar në një procedurë të prokurimit publik. Kjo shkelje nuk është thjesht një devijim teknik, por një cenim i drejtpërdrejtë i parimeve themelore të konkurrencës së ndershme, transparencës dhe trajtimit të barabartë, të garantuara me ligj.

Për më tepër, sjellja e Autoritetit Kontraktues në këtë rast ka ndikuar jo vetëm në vetë mundësinë për të marrë pjesë realisht në garë, por edhe në aftësinë tonë për të ushtruar në kohë të drejtën për mjet juridik efektiv. Mungesa e njoftimit formal dhe të vlefshëm për rifillimin e procedurës, bashkë me përjashtimin faktik që kjo ka prodhuar ndaj “2A Group SH.P.K.”, ka sjellë një dëm të dyfishtë: përjashtim nga gara dhe pamundësi për t’u mbrojtur me kohë. Në këto kushte, nuk kemi të bëjmë me një gabim të izoluar apo një lëshim administrativ, por me një shkelje të qartë që ka prekur vetë themelin e barazisë në garë dhe ka vënë në rrezik integritetin e të gjithë aktivitetit të prokurimit. Kjo është arsyeja pse kjo ankesë kërkon jo vetëm korigjim procedural, por edhe ndërhyrje substanciale për të garantuar respektimin e ligjit dhe të drejtës materiale të operatorit ekonomik të dëmtuar.

Analizë kontekstuale e veprimeve dhe mosveprimeve procedurale

Më datë 04.07.2025, “2A Group SH.P.K.” ka pranuar përmes njoftimit automatik në email-in zyrtar dokumentin “Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit”, i publikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit si dokument shtesë. Ky ka qenë njoftimi i fundit zyrtar dhe publik i dërguar nga sistemi në adresën tonë elektronike përmes të cilit u njoftuam për pezullimin e procedurës. Më datë 09.07.2025, kompania jonë ka marrë një njoftim automatik nga sistemi elektronik, përmes të cilit u informuam se ishte ngarkuar një dokument i ri në dosjen e tenderit. Pas këtij njoftimi, hymë në sistem dhe konstatuam se dokumenti në fjalë ishte “Procesverbali i Hapjes së Ofertave”, gjë që na bëri të kuptojmë se procedura kishte rifilluar. Në

atë moment, ishte hera e parë që u bëme të vetëdijshëm se afati për dorëzimin e ofertës kishte përfunduar, dhe se oferta jonë nuk ishte më e dorëzueshme për shkak të mospasjes së informacionit në kohë reale. Deri në atë ditë, ne nuk kishim marrë asnjë njoftim zyrtar dhe të vlefshëm për rifillimin e procedurës apo për afatin e ri për dorëzimin e ofertave. Gjatë shqyrtimit të dosjes manualisht në sistem, zbuluam gjithashtu se me datë 07.07.2025 ishte ngarkuar një dokument me titull “Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim”, i cili përmbante vendimin për rifillimin e procedurës.

Ky dokument:

nuk ishte publikuar si dokument shtesë në dosjen e tenderit;

nuk ishte shpërndarë përmes ndonjë forme zyrtare të njoftimit në sistem (si p.sh. funksioni “Publikimi i B58, B54, B52, B10, B08...”);

dhe nuk ishte shoqëruar me asnjë njoftim automatik në email për OE-në tonë.

Për të dëshmuar seriozitetin dhe transparencën tonë në këtë situatë, “2A Group SH.P.K.”, sapo është vënë në dijeni për rifillimin e procedurës (në mënyrë tërthorazi përmes dokumentit “Procesverbali i hapjes së ofertave” të publikuar në sistem më 09.07.2025), ka paraqitur një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më datë 11.07.2025, duke ngritur zyrtarisht shqetësimin për mungesën e njoftimit formal dhe pamundësinë reale për të marrë pjesë në garë. Kjo kërkesë e dorëzuar me përgjegjësi e në përputhje me nenin 108/A të LPP-së është dëshmi e qartë se operatori nuk ka qenë pasiv, por është përpjekur me mjete ligjore të reagojë ndaj një shkeljeje që tashmë ka prodhuar pasoja të pakthyeshme. Megjithatë, duke qenë se njoftimi nuk ishte bërë në përputhje me standardet ligjore dhe nuk ishte krijuar një afat proceduror i vlefshëm për të gjithë operatorët, kjo kërkesë nuk pati efekt ndalues dhe procedura vijoi në mënyrë të njëanshme.

Për të vlerësuar veprimet e Autoritetit Kontraktues dhe për të verifikuar nëse ka ndodhur një shkelje e standardeve të komunikimit, “2A Group SH.P.K.” i është drejtuar zyrtarisht KRPP-së me një kërkesë për sqarim, menjëherë pas zbulimit të vonuar të rifillimit të procedurës. Kjo kërkesë është bërë me qëllim që të kemi një vlerësim institucional mbi mënyrën se si është trajtuar vendimi i datës 07.07.2025 nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe nëse janë respektuar detyrimet për njoftim zyrtar dhe publik.

Në përgjigjen e saj zyrtare, KRPP ka konfirmuar në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar se: dokumenti i datës 04.07.2025 mbi pezullimin e procedurës ishte i komunikuar publikisht dhe i shoqëruar me njoftim automatik për të gjitha palët;

dokument i datës 07.07.2025 mbi rifillimin e procedurës ishte dërguar vetëm te OE që kishte parashtruar kërkesën për rishqyrtim, pa publikim për të tjerët;

nuk është përdorur funksioni B58 dhe asnjë kanal tjetër formal që do të siguronte njoftim për OE-të të cilët kishin shkarkuar të gjithë dokumentacionin, çka do të thotë se sistemi nuk ka aktivizuar sinjalizimin për rifillimin;

kufizimi i njoftimit për një OE të vetëm lejohet vetëm në fazën “në vlerësim”, e cila nuk ishte rasti;

dhe përgjegjësia për këtë shkelje i takon ekskluzivisht Autoritetit Kontraktues.

KRPP konstatoi se Autoriteti Kontraktues nuk ka përdorur asnjë formë të vlefshme komunikimi për njoftimin e rifillimit të procedurës me datë 07.07.2025, duke dërguar vendimin vetëm te një operator i vetëm, pa publikim për të tjerët, pa përdorur funksionin B58, B54, B52, B10, B08... dhe pa gjeneruar njoftim automatik për operatorët tjerë, në kundërshtim me rregullat dhe përgjegjësinë që i takon ekskluzivisht vetë Autoritetit Kontraktues.

Për më tepër, fakti që disa operatorë kanë dorëzuar ofertë, ndërsa disa operatorë nuk kanë dorëzuar ofertë përfshi këtu edhe “2A Group SH.P.K.”, konfirmon se nuk ka qenë në dijeni të rifillimit, dhe ky është një tjetër tregues objektiv i mungesës së një njoftimi të vlefshëm dhe të përgjithshëm. Informimi që ndodh përmes monitorimit manual të sistemit ose përmes burimeve jozyrtare nuk mund të zëvendësojë detyrimin ligjor për njoftim formal automatik, siç përcaktohet në nenin 55 të LPP-së për mënyrat e vlefshme të komunikimit dhe në rregulloret dhe manualët e miratuara nga KRPP.

Ky është një veprim i njëanshëm, selektiv dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

Nenin 7 të LPP-së (parimi i barazisë dhe transparencës),

Rregulloren e konsoliduar për zbatimin e LPP-së (001/2022 me ndryshimet e 002/2024),

dhe manualët zyrtarë të KRPP-së, të cilat janë dokumente detyruese sipas nenit 87.2.4 të LPP-së.

Në përputhje me nenin 112 të Ligjit për Prokurimin Publik, me dorëzimin e kësaj ankese, kërkojmë që aktiviteti i prokurimit përkatës të pezullohet menjëherë dhe në mënyrë të plotë, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga paneli shqyrtues i OSHP-së. Kjo kërkesë është bërë për shkak se Autoriteti Kontraktues ka vazhduar me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, pavarësisht shkeljeve të rënda procedurale të konstatuara, duke rrezikuar cenimin e mëtejshëm të integritetit të procedurës. Pezullimi është masë mbrojtëse e domosdoshme për të parandaluar dëme të pakthyeshme ndaj të drejtave të operatorit ankues dhe për të garantuar efektivitetin e mjetit juridik.

Vlerësimi juridik dhe kërkesa për ndërhyrje institucionale

Kjo shkelje procedurale ka prodhuar pasoja të pariparueshme për disa operatorë që nuk kanë dorëzuar ofertë përfshi këtu edhe “2A Group SH.P.K.”, të cilët janë përjashtuar në mënyrë faktike nga gara për shkak të mungesës së njoftimit të vlefshëm dhe formal për rifillimin e procedurës.

Bazuar në nenin 62 të LPP-së, që parashikon se shkeljet jo të korrigjueshme janë arsye për anulimin e procedurës, kërkojmë nga OSHP që:

të konstatojë këtë shkelje si të rëndë, të qartë dhe të patolerueshme;

dhe të vendosë anulimin e procedurës së prokurimit, për shkak të cenimit të së drejtës për pjesëmarrje dhe të integritetit të garës.

Për ta ilustruar më qartë këtë shkelje, vlen të përmendet se sjellja e Autoritetit Kontraktues në këtë rast bie ndesh edhe me standardin që vetë ai ka ndjekur për vendime të mëparshme identike në përmbajtje. Konkretisht:

Më datë 02.07.2025, një operator ekonomik kishte paraqitur një kërkesë për rishqyrtim, dhe si pasojë, Autoriteti Kontraktues e kishte pezulluar procedurën. Ky vendim ishte i publikuar dhe i njoftuar për të gjithë operatorët përmes sistemit dhe përmes email-it zyrtar, ashtu siç e kërkon procedura.

Më datë 03.07.2025, Autoriteti Kontraktues kishte marrë vendim për refuzimin e asaj kërkesë për rishqyrtim dhe për rifillimin e procedurës. Edhe ky vendim ishte i publikuar në mënyrë të hapur dhe ishte shoqëruar me njoftim automatik për të gjithë operatorët, përfshirë “2A Group SH.P.K.”.

Më datë 04.07.2025, një tjetër operator kishte dorëzuar një kërkesë për rishqyrtim, dhe Autoriteti Kontraktues kishte vepruar në të njëjtën mënyrë si në rastin e datës 2 – kishte pezulluar sërish procedurën dhe kishte publikuar vendimin për pezullim në mënyrë të hapur për të gjithë OE-të, duke e shoqëruar me njoftim automatik në sistem.

Megjithatë, më datë 07.07.2025, për të njëjtin rast procedural (refuzimi i një kërkesë për rishqyrtim dhe rifillimi i procedurës), Autoriteti Kontraktues nuk e ka publikuar vendimin si dokument shtesë në sistem, nuk ka përdorur ndonjë formë njoftimi formal, dhe nuk ka gjeneruar asnjë njoftim automatik për operatorët ekonomikë.

Ky është pikërisht thelbi i shkeljes: AK ka ndjekur një standard të caktuar procedural për datat 02, 03 dhe 04 Korrik 2025, duke i njoftuar të gjithë operatorët për pezullim dhe për rifillim të procedurës, por këtë standard e ka braktisur pikërisht për vendimin e datës 07.07.2025, edhe pse natyra e vendimit ishte identike. Kjo tregon trajtim të pabarabartë për situata të njëjta, gjë që përbën shkelje serioze të parimeve të barazisë, transparencës dhe sigurisë procedurale. Për pasojë, ne mbetëm të painformuar, të papërfshirë dhe realisht të përjashtuar nga procesi i dorëzimit të ofertës, për shkak të mungesës së njoftimit formal për rifillimin e procedurës dhe për afatin e rihapur të dorëzimit.

Shkelja e detyrimeve ligjore dhe procedurale nga ana e Autoritetit Kontraktues – në veçanti, mosnjoftimi formal dhe i vlefshëm për rifillimin e procedurës së prokurimit – ka prodhuar pasoja konkrete dhe të menjëhershme financiare për “2A Group SH.P.K.”.

Kjo shkelje ka rezultuar në:

Humbjen e mundësisë për të dorëzuar ofertë, për shkak të mungesës së njoftimit për rifillimin dhe për afatin e ri të dorëzimit;

Si pasojë, përjashtimin faktik të “2A Group SH.P.K.” nga gara, duke e vendosur në pozitë të pabarabartë me operatorët e tjerë që kanë pasur dijeni ose akses në mënyrë të parregullt;

Kjo përjashton mundësinë për të konkurruar dhe për të fituar kontratën, çka përbën një dëmtim real të interesit ekonomik dhe të mundësisë për të realizuar të ardhura që burojnë nga ajo kontratë;

Për më tepër, çdo vendim i mëtejshëm që lejon vazhdimin e procedurës dhe lidhjen e kontratës, duke injoruar pezullimin automatik të parashikuar në nenin 112 të LPP-së, do të përkeqësonte dëmin e shkaktuar, duke e bërë të pakthyeshme mundësinë e kontraktimit për OE-në tonë.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "2A Group Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 11.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i mbeturinave" me nr. të prokurimit 616-24-11988-2-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është fare pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Shih procesverbalin e hapjes së ofertave të datës 09.07.2025. Ky fakt nuk kontestohet as nga vetë parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se "Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi, duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Dorëzohet përmes nenit 59 paragrafit 1 të RRPP ku është përcaktuar se "kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet pa pagesë nga cilado palë e interesuar...". Në këtë mënyrë është gjetur se nuk janë përmbushur kushtet për të parashtruar kërkesën për rishqyrtim në kuptim të nenit 59 paragrafit 1 të RRPP, për shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 1 të RRPP lidhur me nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafi 26 të LPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin c) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2 të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 31.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0680, ndërsa me datë 02.08.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0680, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e 2A Group SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0680 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Ankesa e “2A Group SH.P.K.”, e parashtruar më 21.07.2025, ka të bëjë me mosnjoftimin formal nga Autoriteti Kontraktues për rifillimin e procedurës së prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave”. Si pasojë, operatori nuk ka pasur mundësi të dorëzojë ofertë dhe është përjashtuar faktikisht nga gara. Ankuesi pretendon shkelje të parimeve të barazisë dhe transparencës, si dhe refuzim të pajustificuar të kërkesës për rishqyrtim. KRPP ka konfirmuar se njoftimi nuk është bërë sipas rregullave. Ankuesi kërkon anulimin e procedurës për shkak të shkeljeve jo të korrigjueshme.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga OE “2A Group SH.P.K.” kundër Komunës së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave” (nr. i prokurimit: 616-24-11988-2-1-1). Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, vendimeve të Autoritetit Kontraktues dhe dokumenteve të bashkëngjitura nga pala ankues, eksperti paraqet sa vijon:

Pretendimi Ankimor Nr. 1:

Ankuesi pretendon se është përjashtuar nga mundësia për të dorëzuar ofertë, si rezultat i mosnjoftimit në mënyrë formale dhe të vlefshme nga ana e Autoritetit Kontraktues lidhur me rifillimin e procedurës së prokurimit, pas pezullimit të saj me vendimin e datës 04.07.2025.

Ndërkohë që ky vendim për pezullim ishte komunikuar si dokument shtesë përmes sistemit dhe i shoqëruar me njoftim automatik në adresën elektronike të OE-së, vendimi pasues i datës 07.07.2025, me të cilin është rifilluar procedura, nuk është shpërndarë në të njëjtën mënyrë. Ankuesi pretendon se ky i fundit nuk është publikuar si dokument shtesë në sistemin e e-prokurimit, nuk është shpërndarë përmes funksionit B58, dhe as nuk është përdorur ndonjë formë tjetër komunikimi që konsiderohet e vlefshme në kuptim të nenit 55 të LPP-së, Rregullores 001/2022, dhe manualeve të KRPP-së, të cilat janë dokumente me karakter detyrues në bazë të nenit 87.2.4 të LPP-së.

Sipas ankuesit, sistemi nuk ka gjeneruar asnjë njoftim automatik për rifillimin e procedurës dhe operatori ekonomik ankues nuk është vënë në dijeni për afatin e ri për dorëzimin e ofertave, duke humbur në këtë mënyrë të drejtën për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

Kronologjia e zhvillimeve procedurale

Kërkesa e parë për rishqyrtim

02.07.2025, ora 14:28 – Dorëzohet kërkesa e parë për rishqyrtim nga një operator ekonomik.

02.07.2025, ora 15:20 – Autoriteti Kontraktues merr vendim për pezullimin e procedurës.

03.07.2025, ora 16:35 – Vendimi për refuzimin e kësaj kërkesë publikohet në sistem si “shto dokument shtesë”, në përputhje me Rregulloren për Prokurimin Publik.

Vërejtje: Autoriteti Kontraktues nuk ka publikuar kërkesën për rishqyrtim në platformë tek dosja e tenderit në seksionin “Shto dokument shtesë”, siç kërkohet me nenin 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Kërkesa e dytë për rishqyrtim

04.07.2025, ora 15:30 – Dorëzohet kërkesa e dytë për rishqyrtim nga OE “2A Group SH.P.K.”.

04.07.2025, ora 16:08 – Autoriteti Kontraktues merr vendim për pezullimin e procedurës.

07.07.2025, ora 11:31 – Vendimi për refuzimin e kësaj kërkesë, si të jashtëafatshme, nuk publikohet në seksionin “shto dokument shtesë”, por i dërgohet vetëm në mënyrë individuale operatorit që ka dorëzuar kërkesën.

Vërejtje: Edhe në këtë rast, Autoriteti Kontraktues nuk ka publikuar kërkesën për rishqyrtim në seksionin “Shto dokument shtesë”, në kundërshtim me nenin 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, të dhënave të publikuara në platformën elektronike të prokurimit dhe përgjigjes zyrtare të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), eksperti shqyrtues vlerëson si në vijim:

Nga shqyrtimi i procedurës në platformën elektronike të prokurimit rezulton se vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 07.07.2025, përmes të cilit është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e datës 04.07.2025 dhe njëkohësisht është rifilluar procedura e prokurimit, nuk është publikuar në seksionin “Dokumente shtojca”, nuk është shpërndarë përmes ndonjë funksioni zyrtar të sistemit si formulari B54, dhe rrjedhimisht nuk ka gjeneruar njoftim automatik për operatorët e tjerë të regjistruar në aktivitet, ashtu siç obligon neni 63.2 i Rregullores për Prokurim Publik (001/2022).

Megjithëse kjo kërkesë për rishqyrtim është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 60.1 të Rregullores dhe, si e tillë, është refuzuar me të drejtë sipas nenit 62.1 (a), Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrim të pavarur dhe të qartë për të publikuar vendimin mbi refuzimin, në përputhje me nenin 62.2, i cili përcakton se:

“Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.”

Po ashtu, neni 63.2 i së njëjtës Rregullore thekson se:

“Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si ‘Dokument shtesë’ tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.”

Në rastin konkret, një publikim i tillë nuk ka ndodhur.

Ky konstatim është konfirmuar edhe nga KRPP, në përgjigjen e saj zyrtare ndaj një kërkesë të ankuesit, me nr. prot. 50/2025, datë 17.07.2025, ku thuhet se:

“Me datë 07.07.2025 dhe ora 11:31, AK është përgjigjur në ‘Kërkesën për rishqyrtim’ të datës 04.07.2025, përmes ngarkimit të dokumentit ‘Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim 07.07.2025.pdf’. Për këtë përgjigje, sistemi ka dërguar njoftim vetëm te OE që ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim. Në listën e njoftimeve automatike përfshihen të gjitha palët e interesuara vetëm nëse AK publikon dokumente në kuadër të ‘Dokumenteve shtojca’.”

Po ashtu, gjatë shqyrtimit në platformën elektronike të prokurimit nuk është evidentuar as publikimi i vetë kërkesave për rishqyrtim në dosjen e tenderit përmes funksionit “shto dokument shtesë”, siç kërkohet në nenin 61.3 të Rregullores për Prokurim Publik.

Në procedurat e mëhershme, përfshirë kërkesën për rishqyrtim të datës 02.07.2025, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore, duke publikuar vendimet për pezullim dhe refuzim si dokumente shtesë në sistem, duke siguruar njoftim automatik për të gjithë operatorët. Në rastin e datës 07.07.2025, një praktikë e tillë nuk është ndjekur, ndonëse efekti juridik i vendimit ishte i njëjtë – rifillimi i procedurës së prokurimit.

Në këto rrethana, edhe pse përgjigjja ndaj kërkesës ishte adresuar vetëm te OE që e kishte parashtruar, rifillimi i procedurës e obligonte Autoritetin Kontraktues që të informonte në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të, në përputhje me nenin 55 të LPP-së dhe parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë nga neni 7 i LPP-së.

Mungesa e këtij njoftimi ka ndikuar drejtpërdrejt në të drejtën e operatorit ekonomik ankues për të marrë pjesë në procedurë, duke i pamundësuar dorëzimin e ofertës brenda afatit. Kjo situatë ka prodhuar pasoja që, në këtë fazë të aktivitetit, nuk mund të korrigjohen në mënyrë efektive, në kuptim të nenit 62 të LPP-së, i cili parasheh mundësinë e anulimit të një aktiviteti në rast se nuk ekziston ndonjë masë tjetër e përshtatshme për rikthimin e pozitës së OE-së.

Bazuar në arsyet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka garantuar komunikim formal dhe të barabartë për rifillimin e procedurës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të LPP-së, nenet 62.2 dhe 63.2 të Rregullores për Prokurim Publik, si dhe parimet e përgjithshme të barazisë dhe transparencës të parashikuara në nenin 7 të LPP-së.

Mosshpërndarja e këtij vendimi në formën e kërkuar ka prodhuar pasoja të natyrës jo të korrigjueshme, duke e përjashtuar operatorin ekonomik ankues nga mundësia reale për të konkurruar. Pretendimi ankimor i OE “2A Group SH.P.K.” konsiderohet i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 2:

Ankuesi konsideron se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me operatorët e tjerë ekonomikë, të cilët janë njoftuar dhe kanë dorëzuar ofertat, ndërkohë që vetë ankuesi ka mbetur jashtë procesit për shkak të mungesës së njoftimit për rifillimin e procedurës. Sipas ankuesit, Autoriteti Kontraktues ka dërguar vendimin e rifillimit të procedurës vetëm te një operator që kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim, ndërsa nuk ka bërë asnjë njoftim publik për operatorët e tjerë, duke krijuar kështu një situatë të pabarazisë së qasjes në informacion. Ankuesi thekson se edhe vetë KRPP, në përgjigjen e saj zyrtare, ka konfirmuar se nuk është përdorur forma e vlefshme e njoftimit dhe se kjo sjellje përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së dhe të parimeve të barazisë dhe konkurrencës së ndershme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimit dhe përgjigjes zyrtare të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), konstatohet se vendimi i datës 07.07.2025 për rifillimin e procedurës nuk është publikuar në ndonjë formë të vlefshme që do të siguronte njoftimin e barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të regjistruar në aktivitet.

Ashtu siç është konfirmuar nga KRPP, edhe eksperti shqyrtues, gjatë verifikimit në sistem, ka konstatuar se ky vendim nuk është publikuar në seksionin “Dokumente shtesë” dhe nuk është përdorur asnjë funksion standard i sistemit (si formulari B54) që do të siguronte njoftim automatik për të gjithë OE-të e regjistruar në procedurë.

Mungesa e një publikimi të tillë ka rezultuar në trajtim të pabarabartë midis operatorëve: disa janë informuar dhe kanë dorëzuar ofertat e tyre, ndërsa të tjerët, përfshirë operatorin ankues, kanë mbetur të painformuar. Kjo situatë bie ndesh me parimin e barazisë së trajtimit dhe transparencës, të garantuar me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

“Autoritetet kontraktuese janë të detyruara të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe të zhvillojnë procedurat e prokurimit në mënyrë transparente.”

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 3:

Ankuesi “2A Group SH.P.K.” pretendon se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se ankuesi nuk ka dorëzuar ofertë dhe, si rrjedhojë, nuk ka statusin e “palës së interesuar”. Sipas ankuesit, ky qëndrim përbën keqinterpretim të nenit 4.1.26 të LPP-së, pasi koncepti “palë e interesuar” përfshin çdo operator që ka shprehur interes dhe ka qenë i lidhur me procedurën, pavarësisht nëse ka dorëzuar ofertë apo jo. Mospjesëmarrja në dorëzimin e ofertës, sipas ankuesit, është pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së AK-së lidhur me mosnjoftimin formal për rifillimin e procedurës dhe jo zgjedhje apo mungesë interesi nga ana e OE-së.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3:

Çështja e ngritur në këtë pretendim lidhet me legjitimitetin e operatorit ekonomik ankues për të paraqitur kërkesë për rishqyrtim, në rrethanat kur nuk ka dorëzuar ofertë. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar shqyrtimin e kësaj kërkeje, duke argumentuar se “2A Group SH.P.K.” nuk përmbush statusin e “palës së interesuar”.

Ky interpretim, megjithatë, nuk është në përputhje me përkufizimin ligjor të dhënë në nenin 4.1.26 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit:

“Palë e interesuar – personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi, duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.”

Nga kjo dispozitë kuptohet qartë se dorëzimi i ofertës nuk është kusht i domosdoshëm për të fituar statusin e palës së interesuar. Mjafton që operatori ekonomik të jetë prekur ose të

rrezikohet të preket nga një veprim apo mosveprim i Autoritetit Kontraktues.

Në rastin konkret, siç është analizuar edhe në përgjigjen ndaj Pretendimit Nr. 1, mospjesëmarrja e operatorit ankues në dorëzimin e ofertës ka rezultuar nga mungesa e një njoftimi formal dhe të vlefshëm për rifillimin e procedurës, në kundërshtim me nenin 63.2 të Rregullores për Prokurim Publik dhe me parimet e nenit 7 të LPP-së. Ky fakt është konfirmuar edhe nga KRPP në përgjigjen zyrtare, ku thuhet se dokumenti i datës 07.07.2025 nuk është publikuar si “Dokument shtesë” dhe, për rrjedhojë, nuk ka gjeneruar njoftim për operatorët tjerë të regjistruar në aktivitet.

Në këto rrethana, operatori ankues është vendosur në pozitë të disfavorshme si rezultat i një mosveprimi të AK-së, dhe si i tillë, përmbush kriteret për të cilësuar si palë e interesuar, sipas përkufizimit ligjor.

Mbështetur në arsyet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues vlerëson se refuzimi i kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se OE nuk ka dorëzuar ofertë, nuk është në përputhje me nenin 4.1.26 të LPP-së, dhe se “2A Group SH.P.K.” ka pasur të drejtë legjitime për të kërkuar mbrojtje juridike në këtë rast.

Prandaj, pretendimi ankimor Nr. 3 vlerësohet si i bazuar.

PËRFUNDIM

Mbështetur në të gjitha arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk është garantuar zbatimi i plotë i parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht të nenit 7 (barazia dhe transparencja) dhe nenit 55 (informimi i pjesëmarrësve), të cilat kërkojnë trajtim të drejtë dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë në procedurë.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit janë evidentuar mospërputhje procedurale që kanë ndikuar në barazinë e pjesëmarrjes dhe në ushtrimin efektiv të të drejtave ligjore nga ana e operatorëve ekonomikë, përfshirë:

Mosshpërndarjen e vendimit të datës 07.07.2025 (për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe rifillimin e procedurës) në formën e përcaktuar si “dokument shtesë”, siç kërkohet me nenin 63.2 të Rregullores për Prokurim Publik. Ky veprim nuk ka gjeneruar njoftim automatik për operatorët tjerë të regjistruar në sistem, duke cenuar qasjen e barabartë në informacion.

Mungesën e publikimit të vetë kërkesave për rishqyrtim në dosjen e tenderit përmes funksionit “Shto dokument shtesë”, në kundërshtim me kërkesën e nenit 61.3 të Rregullores për Prokurim Publik, çka ka ndikuar në mungesën e transparencës gjatë trajtimit të mjeteve juridike.

Në këto rrethana, dhe në përputhje me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, eksperti shqyrtues rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit, me qëllim të rivendosjes së parimeve të transparencës, barazisë dhe trajtimit të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

Këto devijime kanë ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë për pjesëmarrje të barabartë dhe në ushtrimin efektiv të mjeteve juridike, duke cenuar parimet e barazisë, konkurrencës dhe sigurisë juridike në procedurë.

-Konstatimi dhe përfundimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se ky OE nuk mund të ketë të drejtën sikurse parashihet në Neni 108/A i LPP-se , ngase nga të gjeturat në këtë procedurë e cila është inicuar nga AK-ja sipas datës 18.11.2024, Paneli Shqyrtues nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe as me administratën e OSHP, e cila e ka pranuar këtë ankesë dhe ka futur në shqyrtim ankesën e këtij OE , veprim i cili konsiderohet të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, dhe Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative. Autoriteti kontraktues mund të ketë bërë shumë shkelje gjatë udhëheqjes së një procedure dhe për këto shkelje mban përgjegjësi vet zyrtarët e AK, por ankesa në OSHP është proces i ndarë dhe duhet të plotësohen kushtet formale-ligjore dhe administrative për tu trajtuar nga OSHP-ja. Neni 108/A i LPP qartë ka përcaktuar afatin për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim kur ajo bëhet në secilen fazë dhe nga kush mund të bëhet, të drejtën për ankimim.

Po ashtu, edhe neni 111 i LPP- së përcakton se për t'u pranuar një ankesë duhet të plotësohen disa kushte, dhe njëri ndër ta është të jetë palë me interes, e në këtë rast OE ankues nuk konsiderohet se është palë me interes në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së , sepse përveç që Kërkesa për Rishqyrtim, edhe Ankesa pranë OSHP-së është pas hapjes së tenderit (datës 09.07.2025) , OE ankues nuk ka marrë pjesë fare në këtë procedure, dhe ankesa është parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së. Hapja e ofertave ka qenë 09.07.2025, OE ankues ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-se me datën 11.07.2025, pa qenë fare ofertues, ndërsa ankesën e ka deponuar pranë OSHP-se me 21.07.2025.

Paneli Shqyrtues vlerëson se parashtruesi i ankesës ka pasur mundësi ta atakojë procedure duke nisur nga faza nga publikimi të Njoftimit për Kontratë (nga data kur është bërë publikimi 18.11.2024) , dhe konform afateve të përcaktuara ligjore.

Autoriteti kontraktues – “Kuvendi i Komunës së Prishtinës”, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull “Menaxhimi i mbeturinave”, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1,) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veprojë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, dhe 7 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Poashtu nuk vërehet se ka ndonjë reagim nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (Dialog me AK), sikurse parashihet në nenin 91 i Ligjit të Prokurimit Publik.

Duke qenë se OE ankues me rastin e parashtrimin të ankesës ka paguar tarifë, e njëjta konform nenit 31, par 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet OE ankues. I njëjti obligohet që kërkesën për kthim të mjeteve ta parashtrojë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 të rregullores së cituar më lartë.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - 2A Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: